



Prishtinë, 28 shkurt 2019
Kodi i ZRRE-së: V_1117_2019

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Duke marrë parasysh:

- Dispozitat e Nenit 9 paragrafi 1, nënparagrafi 1.7, Nenit 15, Nenit 26, Nenit 28 paragrafi 2, nënparagrafi 2.1, Nenit 30, Nenit 32 paragrafin 2, nënparagrafi 2.1, Nenit 34 dhe Nenit 38 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084);
- Dispozitat e Nenit 6 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 05/L-085) ;
- Dispozitat e Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë (Rregulla Nr.07/2017);
- Marrëveshjen për Blerje të Energjisë (MBA) për Kapacitetet Gjeneruese nga Burimet e Ripërtërishme të Energjisë, mbështetur nga Rregulla për Skemën Mbështetëse, të lidhur me datë 24.07.2018 në mes ndërmarrjes "Air-Energy" SH.P.K dhe Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut (KOSTT) SH.A, të datës 11.10.2018;
- Aplikacionin për Licencim të Aktivitetit të Prodhimit të Energjisë Elektrike të dorëzuar në Rregullator me datë 17.07.2018 nga ndërmarrja "Air-Energy" SH.P.K, adresa Rr. Isa Boletini, n.n., 60000, Gjilan, Republika e Kosovës, si dhe
- Njoftimin e datës 21.01.2019 të dorëzuar nga "Air-Energy" SH.P.K në Rregullator për lëshimin e Vendimit për Leje Mjedisore nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), me Nr. Prot: 5314-2/18, të datës 18.01.2019.

në seancën e mbajtur me datë 28 shkurt 2019, nxori këtë:

VENDIM

- I. I LËSHOHET LICENCA** për prodhim të energjisë elektrike nga burimet e ripërtërishme të energjisë nga Parku me Erë "Kitka", ndërmarrjes "Air-Energy" SH.P.K, me numër licence ZRRE/Li_62/19.
- II.** Licenca e ndërmarrjes "Air-Energy" SH.P.K do të jetë e vlefshme nga data 11.10.2018 (kur gjeneratori ka hy në operim komercial) deri me datë 10.10.2058.
- III.** Neni 1 dhe Neni 25 i licencës ZRRE/Li_62/18, i datës 15 nëntor 2018, do përshtatet në përputhje me pikën II të dispozitivit të këtij Vendimi, ndërsa të gjitha dispozitat tjera të licencës mbesin të njëjta.



IV. **Shfuqizohet** vendimi nr. V_1070_2018, i datës 15 nëntor 2018, i lëshuar nga Bordi i Rregullatorit, sipas të cilit vendim ndërmarrjes "Air-Energy" SH.P.K, në mungesë të Lejes Mjedisore, i është lëshuar Licencë e Përkohshme për periudhën 11.10.2018 deri 10.10.2019.

V. **Obligohet** ndërmarrja të sjell në Rregullator çdo dokument të lëshuar nga institucione të ndryshme për "Air-Energy" SH.P.K, të cilët mund të kenë ndikim në validitetin dhe periudhën e vlefshmërisë së licencës së lëshuar, si dhe çdo dokument i cili mund të ndryshoj nga ai i sjellë gjatë aplikimit për marrje të licencës.

Arsyetim

- Zyra e Rregullatorit për Energji (Rregullatori) me datë 17.07.2018 ka pranuar Aplikacionin me dëshmitë përkatëse për Licencim të aktivitetit të Prodhimit të energjisë elektrike në Kosovë nga Ndërmarrja "Air-Energy" SH.P.K., nga gjeneratori WIND PARK KITKA, me kapacitet të instaluar prej 32.4 MW .
- Për licencim të aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike, përveç tjerash kërkohet edhe Leja Mjedisore e Integruar. "Air-Energy" SH.P.K. në pamundësi të nxjerrjes së Lejes Mjedisore të Integruar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), ka dorëzuar në Rregullator Kërkesën e dorëzuar në MMPH me datë 18.09.2018 për t'u pajisur me Leje Mjedisore të Integruar.
- Rregullatori, duke u bazuar në Nenin 5 paragrafin 6 të Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë, me datë 15 nëntor 2018 i ka lëshuar licencë të **përkohshme** ndërmarrjes në fjalë, për periudhën 11.10.2018 deri më 10.10.2019, me kusht që të sjellë në Rregullator Lejen Mjedisore të Integruar, brenda dymbëdhjetë (12) muajsh nga data e hyrjes në operim të gjeneratorit të kësaj ndërmarrjeje.
- Me datë 21 janar 2019, përfaqësues të "Air Energy SHPK" kanë dërguar në rregullator "**Vendimin për Leje Mjedisore**", të lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor me datë 18.01.2019, me Nr. Prot. 5314-2/18, Njësia DMMU, për veprimtarinë në parkun energjetik me erë "KITKA" me kapacitet prej 32.4 MW, në lokacionin e komunës së Kamenicës. Leja mjedisore është lëshuar për "Air Energy SHPK" për periudhën pesë (5) vjeçare.
- Vendimi për Leje Mjedisore është lëshuar nga MMPH për turbinat e vendosura në zonën kadastrale për të cilat posedon Pëlqim Mjedisor (nr 15/4081/1-ZSP/173/15 të dt. 22.09.2015) dhe Leje Ndërtimore (nr. 3387-2/18 me nr. reference ZSP-675/2018 dt. 05.07.2018).
- Ndërmarrja "Air-Energy" SH.P.K, bazuar në nenit 8.1 të Rregullës për licencimin e aktiviteteve të Energjisë në Kosovë, ka publikuar njoftimin në gazetë (datë 26.10.2018), duke informuar kështu palët e interesit se kanë dorëzuar aplikacionin në Rregullator për Licencë të prodhimit të energjisë elektrike dhe se ai aplikacion është në fazën finale për marrje të licencës. Palët e interesit kanë pasur të drejtë të kundërshtojnë aplikacionin, nëse dëshmojnë ndonjë parregullsi të tij. Palët e interesit nuk kanë kundërshtuar këtë aplikacion.
- Rregullatori ka vlerësuar se ndërmarrja në fjalë ka vepruar sipas udhëzimeve të Rregullatorit, kërkesave të parapara në Aplikacionin për Licencim të aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike dhe legjislacionit tjetër në fuqi. Kështu pas pranimit nga ndërmarrja në fjalë të Lejes



Mjedisore të lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, Bordi i Rregullatorit ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

VI. Vendimi nxirret në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

VII. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i Rregullatorit dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të Rregullatorit.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të Rregullatorit, cilado që ndodh e fundit.

Vendimi i dërgohet:

- Ndërmarrjes "Air-Energy" SH.P.K,
- Arkivit të Zyrës së Rregullatorit për Energji

Bordi i ZRRE-së:

Arsim Janova, u.d. Kryesues

Besim Sejfiqaj, anëtar

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar